



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.329/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 200.00 (*dyqind*) euro, për shkak të thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, të cilën gjorbë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën **kërcënim të përmbarimit**.

## A r s y e t i m

Më datën 22.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN) dhe Internews Kosova (IKS) me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, Bahri Hasani, në profilin e tij në facebook me datë 21 tetor 2017 në ora 8 e 14 në mbrëmje, ka shpërndarë fotografën e tij me logon e PDK-së dhe fletëvotimin që sugjeron të votohet PDK dhe numri i tij. Sipas parashtruesit të ankesës ky veprim bie ndesh me nenin 36 paragrafi 1 pika b të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi .

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik PDK, të datës 23.10.2017, ka theksuar se pretendimet ankimore nga parashtruesi i ankesës janë të pabaza dhe në foton e ankuesit si provë shihet se shpërndarja e statusit nga kandidati i tyre është bërë 13 orë përpara dhe jo në kohën e heshtjes zgjedhore siç pretendohet në ankesë. Më tej ka theksuar se data e cila shihet në foto është vetëm një montim dhe nuk paraqet kohën e saktë. Po ashtu kanë theksuar se në kohën e heshtjes zgjedhore dhe as tani në profilin e kandidatit të PDK-së nuk ka pasur status

të postuar si ky. PDK e quan si tendencioze këtë ankesë dhe kërkon nga PZAP që ta hedh poshtë atë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli pas shqyrtimit të provave, fotove të bashkangjitura në ankesë ka vlerësuar në mënyrë të qartë dhe bindëse se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Bahri Hasani, gjatë heshtjes zgjedhore në rrjetin e tij social facebook ka bërë fushate zgjedhore, duke shpërndarë fotografimin e tij me logon e PDK-së dhe fletëvotimin që sugjeron të votohet PDK dhe numri i tij.

Andaj Paneli duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), është përgjegjëse për veprimet e saja, pasi që këto veprime paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike dhe kandidatët, të përcaktuara me nenin 36 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku parashihet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli në kuptim të nenit 118 pika dhe nenit 120. të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.A.nr. 329/2017 më datën 22.10.2017



**Kryesues i Panelit**  
Gyltene Sylejmani

***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.